



CONFINDUSTRIA ALBANIA
Associazione degli Industriali Italiani in Albania

Tiranë, 13 nëntor 2018

KOMUNIKATË PËR SHTYP

PËR LIGJIN NR. 74/2018 “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9518, DATË 18.4.2006 “PËR MBROJTJEN E TË MITURVE NGA PËRDORIMI I ALKOOLIT” TË NDRYSHUAR”

Confindustria Albania - Shoqata e Industrialistëve Italianë në Shqipëri, vlerëson çdo nismë që vjen në dobi të mbrojtjes së shëndetit të konsumatorit, e veçanërisht të fëmijëve, por me anë të kësaj letre synojmë të nxjerrim në pah disa problematika të Ligjit nr. 74/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9518, datë 18.4.2006 “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i Alkoolit” të ndryshuar, i cili është miratuar në Parlament me 75 vota dhe aktualisht ndodhet pranë Institucionit të Presidentit të Republikës për dekretim.

- Ky Ligj prek në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë aktivitetin e biznesit të një pjese të madhe të shoqërive tregtare anëtare të Confindustria Albania.
- Ndryshimet e sjella me këtë Ligj nuk kanë asnjë justifikim apo bazë shkencore dhe janë masa të papërshtatshme për të arritur objektivin e synuar nga Ligji.
- Masat drastike të parashikuara nga ky Ligj, janë tërësisht të pajustificuara në lidhje me pijet e gazuara dhe pijet me sheqer të shtuar, duke pasur parasysh se konsumi vjetor për këto pije është 19 litra/pro capite, konsumi më i ulët në vendet evropiane.
- Ndryshimet e parashikuara ndikojnë jo vetëm për prodhuesit, por edhe në rrjetin shpërndarës.
- Këto ndryshime ndikojnë drejtpërsëdrejti në përqendësimin e klimës së investimeve të huaja në Shqipëri.
- Këto ndryshime, janë miratuar në mungesë të një konsultimi me publikun dhe grupet e interesit, siç parashikohet në ligjin Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Confindustria Albania mbështet iniciativat e organizatave të tjera për këtë çështje.

Përsa më sipër, kërkon që ndryshimet ligjore si më lart të miratuara në Kuvend të kthehen për rishqyrtim nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë duke përcaktuar nevojën e konsultimit publik dhe rishikimit të masave shtesë në etiketim dhe këshillim mbi përmbajtjen e produkteve.